



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.2013/5 prot.

Tiranë më 27.12.2022

REKOMANDIM

Nr. 36, datë 27.12.2022

PËR KONTROLLUESIN “TIRANA FACTORING & LEASE SHA”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “TIRANA FACTORING & LEASE SHA” (në vijim, “Kontrolluesi),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 206, datë 24.11.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, me fokus masat tekniko-organizative për përpunimin e tyre, veçanërisht sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI) dhe verifikim rekomandimi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është një institucion financiar (licensuar nga Banka e Shqipërisë) i specializuar në aktivitetin e faktoring dhe qerasë financiare, regjistruar me numër identifikimi L21801017T dhe ka për objekt të veprimtarisë së saj fushat si “Factoring”, “Leasing” dhe “Këmbime Valutore”.

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë “punonjës”, “klientë”, “furnizues”, “pronar/aksioner”, “garantues”, “bashkë huamarrës”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi disponon arkivin fizik dhe elektronik në të cilën, ndër të tjera, ruan dosjet me dokumentacionin përkatës që plotësohet kur ofrohet shërbimi i Factoring dhe Leasing. Konstatohet se për këto dokumente nuk ka një parashikim në lidhje me kohën e ruajtjes së të dhënave personale, në kundërshtim me germën “d”, të pikës 1, të nenin 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi ka detyrim të përpunojë të dhënat personale për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë grumbulluar dhe përpunuar (neni 5/1/d) dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar të realizojë shkatërrimin e tyre, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e përpunimit.

3. Kontrolluesi disponon faqen online <https://tfl.al/>. Konstatohet se, Kontrolluesi nuk ka të publikuar rubrikën “Politikat e Privatësisë”, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale të cilët aksesojnë këtë faqe, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, personin që do t’i përpunojë, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të tyre, etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, publikimi i rubrikës “Politikat e Privatësisë” në faqen zyrtare të Kontrolluesit përmbush qëllimin e informimit përkundrejt subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë faqen e internetit të Kontrolluesit. Njëkohësisht, informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Kontrolluesi disponon një sistem të brendshëm, për kryerjen e veprimtarisë së përditshme, në të cilin ngarkon të gjitha të dhënat që lidhen me kontratat Factoring dhe Leasing.

Nga analizimi i provave të administruara në dosje rezulton se për çdo problematik të sistemit apo ndryshime të moduleve në të, Kontrolluesi komunikon nëpërmjet “ticket-ave” me kompaninë nga e cila ka blerë shërbimin (*me qendër në Lituanë*). Më pas, nëpërmjet *remote desktop*, kompania futet në sistemin e Kontrolluesit për ndryshimet përkatëse sipas kërkesave.

Konstatohet se Kontrolluesi nuk ka një kontratë për mirëmbajtjen e sistemit të brendshëm që disponon, në të cilën të parashikohen detyrimet e palëve mbi përpunimin e të dhënave personale në zbatim të parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit

të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratoj një kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të përpunuesit të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose shërbimit, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave në përputhje me nenin 20 të Ligjit dhe me parashikimet e Udhëzimit nr. 19.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se Kontrolluesi ka njoftuar mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Gjatë hetimit administrativ të ushtruar, është konstatuar se “Njoftimi” ka mangësi në deklarin, sa i përket rubrikave të formularit si vijon:

- Deklarimin në rubrikën 1.1, të formularit të njoftimit “Të dhënat e subjektit kontrollues”;
- Deklarimi në rubrikën 3.1, të formularit të njoftimit “Kategoritë e subjekteve të dhënave personale që përpunohen”;
- Deklarimi në rubrikën 4.1, të formularit të njoftimit “Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen”;
- Deklarimi në rubrikën 6.1, të formularit të njoftimit “Qëllimi i përpunimit”;
- Deklarimin në rubrikën 7.1, të formularit të njoftimit “Marrësi i të dhënave personale”;

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

6. Kontrolluesi nuk disponon Rregullore “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me qëllim parashikimin e proceseve, procedurave, masave teknike dhe organizative, etj., sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një Rregullore “*për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

7. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare nëpërmjet shkresës nr. 2013/3 prot., datë 13.12.2022.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancë dëgjimore, zhvilluar në datë 19.12.2022, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe u shpreh se “*sa i përket publikimit të “Politikave të Privatësisë” nuk grumbullojmë të dhëna personale nga faqja zyrtare <https://tfl.al/>”*.

Gjithashtu, Kontrolluesit dorëzoi pranë Zyrës së Komisionerit Kontratën me kompaninë e mirëmbajtjes, për sistemin që disponon, si dhe Deklaratën e Pëlqimit “*për përpunimin e të dhënave personale*” e cila i merret çdo subjekti aplikues për shërbim leasing ose factoring.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 18, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje proceset e përpunimit të të dhënave personale, për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të ketë në vëmendje informimin e subjekteve të të dhënave personale për çdo proces përpunimi;
3. Kontrolluesi, të marrë masa të përfshij detyrimet e secilës palë në kontratën me kompaninë e cila mirëmban sistemin, sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit;
4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të “Njoftojë” Zyrën e Komisionerit, për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e Rregullores “për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj;
6. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale;
7. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikat 1 dhe 2 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 4 më sipër;
 - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 3 dhe 5 më sipër;
 - (iv) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 6 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

8. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;

9. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 27.12.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi